



Prof. Asoc. Dr. ALBULENA BLAKAJ- GASHI

Prorektore për bashkëpunim ndërkombëtar

PROFILI

Prorektore nga 15 Tetor 2020. Është profesoreshë e asocuar në Fakultetin e Filologjisë, në departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane. Studimet bazike, ato të magjistraturës dhe të doktoratës i ka përfunduar në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës. Gjatë studimeve, ajo është shpërblyer me bursa të ndryshme, kryesisht nga DAAD për qëndrim studimor në universitetet gjermane. Nga DAAD ka fituar bursë edhe gjatë studimeve të doktoratës dhe ka qëndruar për hulumtim në Universitetet Humboldt dhe Freie Universität në Berlin. Ka ushtruar funksione të ndryshme menaxheriale si sekretare e departamentit, Prodekane për shkencë dhe bashkëpunim ndërkombëtar në F. e Filologjisë, Anëtare e Bordit Drejtues të Qendrës së Studentëve. Ka përvojë 24 vjeçare në procesin mësimor në Arsimin e Lartë. Fusha e saj e interesit dhe ajo e hulumtimit shkencor, është e lidhur me letërsinë gjermane e krahasimtare, receptimin e shkrimtarëve e letërsisë gjermane në kulturën shqiptare, përkthimin dhe mësimdhënien. Ka botuar një numër të konsiderueshëm të punimeve në revista shkencore. Ka publikuar një monografi me titullin *Goethe (Gëte) dhe receptimi i tij në kulturën shqiptare*. Ka udhëhequr projekte të mobilitetit ndërkademi ERASMUS + si pjesë e punës së saj si Prodekane për shkencë e bashkëpunim ndërkombëtar si dhe ka qenë përgjegjëse për implementimin e tyre. Nga 2002 është angazhuar nga MASHT-i si eksperte për shumë çështje që kanë të bëjnë me gjuhën gjermane në Kosovë.

PËRVOJA AKADEMIKE

- 1996-1999 Bashkëpunëtoreshë profesionale në Fakultetin e Filologjisë
- 1999- 2013 Asistente në Fakultetin e Filologjisë
- 2013-2020 Prof. Asistent në Fakultetin e Filologjisë
- 2020- aktualisht Prof. Asocuar në Fakultetin e Filologjisë

PËRVOJA MENAXHERIALE

- 2001- 2007, Sekretare e departamentit
- 2003 – 2005, Anëtare e Bordit Ekzekutiv të Qendrës së Studentëve të UP-së
- 2016- 2020, Prodekane për shkencë dhe bashkëpunim ndërkombëtar në Fakultetin e Filologjisë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë

EDUKIMI

- 1980-1988 Shkolla Filllore 'Faik Konica', Prishtinë
- 1988-1992 Gjimnazi 'Sami Frashëri', Prishtinë
- 1992-1996 Fakulteti i Filologjisë, UP, Prishtinë
- 2008-2012 Doktorata, Fakulteti i Filologjisë, UP, Prishtinë

Data e lindjes: 24. 02. 1974

Vendi i lindjes: Pejë



Rr. George Bush Nr. 31,
10 000 Prishtinë



+383 38 244 180



albulena.blakaj@uni-pr.edu

ANËTARËSIA

- 2007 – 2020- kryetare e Shoqatës Kosovare të Gjermanistëve dhe Mësimdhënësve të Gjermanishtes.
- 2008- aktualisht: Anëtare e kryesisë së Shoqatës së Gjermanistëve të Evropës Juglindore (Südosteuropaischer Germanistenverband)

ÇMIMET

- 2007- çmim për përkthim nga S.Fischer Stiftung dhe LCB (Das Literarische Colloquium Berlin)